



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 746/9 Prot.

Pogradec, më 16.02.2022

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:

PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR 120 DT 24.12.2021

“MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2022”

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2022

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____.____.2022

PËR

**“NJE NDRYSHIM NE VKB NR 120 DT 24.12.2021 “ PËR MIRATIMIN DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të, shkronjës "c", pika 1.3, të nenit 9, neneve 34, 40, 41, shkronjës "dh" të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimin nr.120 datë 24.12.2021” “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2022”, Shkresa nr 407 prot dt 12.01.2022 “ Mbi fondet eper projektet e strehimit per vitin 2022”, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin, në Vendimin e Keshillit të Bashkisë Pogradec nr.120 datë 24.12.2021 për sa më poshtë :

1.1 Të pakesohet në zërin e “Shpenzime operative”, si më poshtë:

Grupi	Kapitulli	Titulli	Artikulli	Kodi Insitucionit	Vlera me TVSH	Kodi i projektit
00	05	01110	602	2136001	6,000,000	Projekte me financim e huaj

1.2 Të shtohet në zërin e investimeve, "Rehabilitim /Perforcim banesash ekzistuese kolektive 2022"
si më poshtë:




Grupi	Kapitulli	Titulli	Artikulli	Kodi Insitucionit	Vlera me TVSH	Kodi i projektit
00	05	06190	231	2136001	6,000,000	"Rehabilitim /Perforcim banesash ekzistuese kolektive 2022"

2. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkise Pogradec.

3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR
Sotiraq MANGERI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ .2022

Relacion

“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në zbatim të ligjit të strehimit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019, VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr. 823, datë 18.12.2019 dhe Shkresa nr 407 prot dt 12.01.2022 “ Mbi fondet eper projektet e strehimit per vitin 2022

Bashkia Pogradec në kuadër të thirrjes nr. 407 prot. datë 12.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për aplikim dhe përfitimin e fondeve për programet e strehimit për vitin 2022 ka hartuar projektin e rikonstruksionit dhe përmirësimit të banesave për komunitetet në nevojë.

Projekti përmban rikonstruksjonin e pjesshëm të banesave individuale me përfitues 30 familje, 150 persona përfitues të drejtpërdrejtë.

Target Grupet përfituese janë persona me aftësi të kufizuar, gra kryefamiljare, familje që trajtohen me ndihme ekonomike, familje me më shumë se 3 fëmijë, familje me 1 prind, të moshuarit, familje rome dhe egjiptiane, etj.

Kërkohet Këshillit të Bashkisë që të miratojë fondin **6’000’000 lekë me TVSH** nga totali prej **30’000’000 Lek me TVSH** si fond i kërkuar për bashkëfinacimim në këtë projekt për rikonstruksionin e banesave për familjet të cilat janë përzgjedhur si më imediatet për të përfituar nga ky projekt.

Ky projekt ka si qëllim përmirësimin e kushteve social-ekonomike të individëve përfitues por edhe një impakt zhvillues për zonën në të cilën do të ndërhyet.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Irsa Karapanca
Miratoi: Johan Sterjo

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI